VENDIM
Nr. 47, datë 30.3.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 4, pika 46 dhe të nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "d", e nenit 1, shfuqizohet.

b) Pas shkronjës "b", të nenit 2, shtohet shkronja "c" me përmbajtjen e mëposhtme:

"nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

c) Në nenin 3, pas togfjalëshit "subjektet financiare jobanka" hiqet togfjalëshi "dhe agjentët e tyre".

d) Përmbajtja e nenit 4 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në shkronjën "c", të pikës 2, para togfjalëshit "personi juridik", shtohet togfjalëshi "personi fizik ose".

ii) Pas shkronjës "h" të pikës 2, shtohen shkronjat "i", "j" dhe "k" me përmbajtje si më poshtë:

"i) "blerja e kredisë" – do të konsiderohet si një nga format e kredidhënies;

j) "subjekt financiar jobankë që blen kredi me probleme" - është subjekti, i cili 100 për qind të portofolit të kredisë e ka të përbërë nga kredi me probleme të blera nga banka ose subjekte të tjera financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

k) "kredi me probleme" – do të ketë kuptimin e parashikuar sipas rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" dhe rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka.".

e) Përmbajtja e nenit 5 ndryshon si më poshtë vijon:

i) shkronja "c" e pikës 1, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

" licencimin e institucionit të parasë elektronike, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, i cili përveç emetimit të parasë elektronike mund të ushtrojë edhe një ose disa nga veprimtaritë financiare të mëposhtme:

i) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;

ii) këmbimin valutor; si dhe

iii) shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë financiare për të cilat është licencuar.";

ii) shkronja "d" e pikës 1 shfuqizohet;

iii) Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6 me përmbajtjet e mëposhtme:

"4. Subjektet financiare jobanka mund të ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, nëpërmjet një ose më shumë agjentëve.

5. Institucionet e parasë elektronike nuk mund të emetojnë para elektronike nëpërmjet agjentëve, por mund të shpërndajnë dhe/ose të ripaguajnë fondet nëpërmjet një ose më shumë agjentëve, të cilët veprojnë për llogari të tij.

6. Subjektet sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, janë përgjegjëse për zgjedhjen dhe identifikimin e agjentëve, si dhe sigurojnë informacionin për:

a) emrin, NUIS[1] dhe adresën e agjentit;

b) emrin dhe numrin e identifikimit të administratorëve dhe personave përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në emër dhe për llogari të subjekteve;

c) pastërtinë penale dhe integritetin e personave sipas shkronjës "b"."

f) Përmbajtja e nenit 6 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Pika 3 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

[1] Numri përkatës i identifikimit të personit të tatueshëm.

"Përjashtimisht nga përcaktimi i shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, kapitali fillestar minimal i kërkuar për subjektet financiare jobanka që blejnë kredi me probleme është 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) lekë.";

ii) Pika 6 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal, çdo shtesë e mëvonshme e tij si dhe çdo ndryshim në strukturën e kapitalit shoqërohet me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën "g" të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.".

g) Pika 2 e nenit 7 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"Licenca e subjektit financiar jobankë përfshin emrin tregtar të subjektit, numrin dhe datën e lëshimit të saj, si edhe ka si pjesë përbërëse të saj aneksin e veprimtarive financiare, për të cilat subjekti licencohet."

h) Përmbajtja e nenit 8 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në pikën 1, pas togfjalëshit "nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre" shtohet togfjalëshi "(sipas formularit nr. 1 të kësaj rregulloreje).";

ii) Në pikën 2, shkronjat "b", "c" dhe "e", shfuqizohen;

iii) Pas nënpikës "vii" të pikës 2, të shkronjës "j", shtohet nënpika "viii" me përmbajtjen e mëposhtme:

"në rastin kur individi i propozuar për administrator është një shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar më sipër, në rast se është e aplikueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë lejen e tij të qëndrimit dhe të punës, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008, "Për të huajt", i ndryshuar.";

iv) Në nënpikën "viii" të shkronjës "k", të pikës 2, togfjalëshi "formulari nr. 6" zëvendësohet me togfjalëshin "formulari nr. 7";

v) Paragrafi i dytë, i shkronjës "l", të pikës 2, ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

"sistemin e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura efektive administrative të kontrollit të brendshëm, dhe në veçanti, procedurat që do të përdoren nga agjentët, për sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.".

j) Pika 3 e nenit 12 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"Banka e Shqipërisë regjistron në regjistrin e subjekteve financiare jobanka listën e agjentëve me të dhënat e këtyre të fundit, të dërguara nga subjektet financiare jobanka sipas formularit nr. 10 të kësaj rregulloreje.";

k) Përmbajtja e nenit 16 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Pas shkronjës "d", të pikës 1, shtohet shkronja "e" me përmbajtjen e mëposhtme:

"të kryejë veprimtarinë si agjent në sigurime.";

ii) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga subjekti brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin.".

l) Përmbajtja e nenit 17 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në pikën 1, togfjalëshi "të parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "d" zëvendësohet me togfjalëshin "të parashikuara në shkronjat "b", "c", "d" dhe "e";

ii) Pas shkronjës "c", të pikës 1, shtohet shkronja "d" me përmbajtjen e mëposhtme:

"për kryerjen e veprimtarisë si agjent në sigurime:

i. vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë;

ii. ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga QKR-ja, në të cilin të jetë përcaktuar veprimtaria e kërkuar; dhe

iii. plan biznesin për tre vitet e ardhshme nga veprimtaria.".

m) Përmbajtja e nenit 21 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Shkronja "g", e pikës 2, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"g) ndryshim të selisë dhe adresës së tij;";

ii) pika "b" e shkronjës "k" të pikës 2 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"b. marrëveshja e nënshkruar me shoqërinë, për realizimin e mbështetjes informatike të aktivitetit të subjektit, nëse ka të tillë;".

n) Kreu III shfuqizohet.

q) Përmbajtja e nenit 31 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Subjektet financiare jobanka, në rast të plotësimit të karakteristikave të institucionit financiar të

mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike të përcaktuara në këtë rregullore, kanë të drejtë të kërkojnë të licencohen si institucione financiare të mikrokredisë ose institucione të parasë elektronike, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë kur licencon subjektin si institucion financiar të mikrokredisë ose institucion të parasë elektronike, revokon njëkohësisht licencën ekzistuese si subjekt financiar jobankë.

2. Institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike, ka të drejtë të kërkojë të licencohet si subjekt financiar jobankë, në rast se do të kërkojë të ushtrojë veprimtari të tjera financiare në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë kur licencon shoqërinë si subjekt financiar jobankë, revokon njëkohësisht licencën ekzistuese si institucion financiar të mikrokredisë ose si institucion i parasë elektronike.".

r) Kërkesa drejtuar Bankës së Shqipërisë për dhënie licence për subjekt financiar jobankë/institucion financiar të mikrokredisë/institucion të parasë elektronike ndryshon si më poshtë vijon:

i) Togfjalëshi "P.s." zëvendësohet me togfjalëshin "Shënim" dhe togfjalëshi "Rruga e Dibrës, kompleksi "Halili"" zëvendësohet me togfjalëshin "Sheshi "Skënderbej", nr. 1".

s) Formularët 2, 3 dhe 8 shfuqizohen.

u) Pas formularit 9 shtohet formulari 10 bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

7. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

FORMULARI NR. 10

LISTA ME TË DHËNAT E AGJENTËVE TË SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË

Nr. .	Emri i agjentit	NUIS (numri përkatës i identifikimit të personit të tatueshëm)	Vendndodhja (adresa)	Administratori (emër, atësia, mbiemër)	Nr. personal i dokumentit identifikues	Rrethi	Qyteti/komuna	Kontakte (e-mail, telefon)